



TELEKOM ALBANIA SH.A.

Adresa: Rr. "Vangjel Noti", Laprakë, Tiranë

GARANCI E KUFIZUAR¹

EMRI, MBIEMRI I KLIENITIT / CUSTOMER NAME, SURNAME	_____		
ADRESA / eMAIL/ ADDRESS/eMAIL	_____		
MSISDN	_____	NUMRI I KLIENITIT / CUSTOMER CODE	_____
MODELI I IPHONE/ IPHONE MODEL	_____	KODI I IPHONE/ IPHONE IMEI	_____
DATA E AKTIVIZIMIT/ ACTIVATION DATE	_____		

FIRMA DHE VULA E SHITËSIT

TË DREJTAT DHE KUFIZIMET E KONSUMATORIT

Për konsumatorët, të cilët mbulohen nga ligji për Mbrojtjen e Konsumatorit ose Rregulloret përkatëse në vendin e tyre të blerjes ose, në raste të tjera, vendit të tyre të qëndrimit, përfitimet e akorduara nga kjo garanci janë shtesë përveç të gjitha të drejtave dhe kompensimeve të akorduara nga Ligjet për Mbrojtjen e Konsumatorit dhe Rregulloret Përkatëse. Kjo garanci nuk përjashton, kufizon apo pezullon të drejtat e Konsumatorit që lindin nga mospërputhja me kushtet e një kontrate shitjeje. Megjithatë, siç përshkruhet dhe më poshtë, Apple heq dorë nga garancitë e parashikura me ligj dhe ato të përfshira brenda hapësirës ligjore, dhe PËR aq sa këto garanci nuk mund të refuzohen, të gjitha këto garanci, brenda hapësirës së lejuar ligjore, do të kufizohen në AFAT KOHOR përsa i takon kohëzgjatjes së garancisë së pasqyruar këtu më poshtë dhe shërbimit TË riparimit ose të zëvendësimit, ASHTU siç përcaktohet dhe konsiderohet e arsyeshme nga Apple. Disa Shtete (Krahina dhe Provinca) nuk lejojnë kufizime lidhur me kohëzgjatjen e një Garancie apo kushti, kështu që kufizimet e përshkruara më lart mund të mos zbatohen në rastin tuaj. Kjo Garanci ju ofron të drejta ligjore specifike, dhe ju mund të keni të drejta të tjera të cilat variojnë nga Shteti në Shtet (ose nga Krahina apo Provinca). Kjo garanci e kufizuar do të Zbatohet dhe interpretohet SIPAS ligjeve TË vendit të blerjes së produktit. Apple, garantuesi në këtë garanci të kufizuar, identifikohet në fund të këtij dokumenti sipas vendit ose rajonit në të cilin ndodh blerja e produktit.

GARANCIA

Detyrimet e garancisë së Apple për këtë produkt hardware kufizohen në kushtet e parashtruara këtu. Apple, siç përcaktohet në tabelën e mëposhtme, garanton këtë produkt hardware të markës Apple kundrejt defekteve në materiale dhe/ose fabrikim gjatë përdorimit normal për një periudhë NJË (1) VJEÇARE nga data e blerjes me pakicë nga blerësi

¹ Vetëm për Produktet e Markës Apple; e vlefshme për një vit

TELEKOM ALBANIA SH.A.

Adresa: Rr. "Vangjel Noti", Laprakë, Tiranë

fundor origjinal ("Periudha e Garancisë"). Nëse ndodh një defekt në hardware dhe dërgohet një ankesë e vlefshme brenda Periudhës së Garancisë, sipas mundësisë së vet dhe brenda hapësirës së lejuar ligjore, Apple ose do të:

1. riparojë defektin në hardware pa asnjë pagesë, duke përdorur pjesë të reja ose të rinovuara të barazvlefshme me pjesët e reja përsa i takon performancës dhe sigurisë,
2. ndërrojë produktin me një produkt të ri ose të rinovuar që është i barazvlefshëm me produktin e ri në performancë dhe siguri dhe është të paktën nga ana funksionale i barabartë me produktin origjinal, ose
3. rimburojë çmimin e blerjes së produktit.

Apple mund të kërkojë që ju të zëvendësoni pjesët defektoze me pjesë të instalueshme nga përdoruesi, të reja ose të rinovuara, të cilat Apple i ofron në përbushje të detyrimeve të veta në këtë garanci. Një zëvendësim produkti apo pjese, duke përfshirë pjesë të instalueshme nga përdoruesi të instaluar në përputhje me udhëzimet e dhëna nga Apple, nënkupton periudhën kohore të mbetur të garancisë së produktit origjinal, ose nëntëdhjetë (90) ditë nga data e zëvendësimit ose e riparimit, cilado ofron kohë më të gjatë mbulimi për ju. Në rastet e ndërrimit të produktit ose një pjesë të tij, çdo pjesë e zëvendësuar bëhet pronë e Apple. Pjesët që do të ofrohen nga Apple, në përbushje të detyrimeve të veta ndaj garancisë, duhet të përdoren në produktet për të cilat kërkohet shërbimi i zëvendësimit. Në rastet e rimbursimit, produkti për të cilin është dhënë rimbursimi duhet t'i kthehet Apple dhe bëhet pronë e kompanisë Apple.

PËRJASHTIMET DHE KUFIZIMET²

Brenda hapësirës së lejuar ligjore, kjo garanci dhe rregullimet e parashtruara më lart janë ekskluzive dhe në vend të të gjitha garancive të tjera, rregullimeve dhe kushteve, qoftë verbale, me shkrim, të detyrueshme, të shprehura qartë apo të përfshira, siç e lejon dhe ligji i zbatueshëm, Apple veçanërisht refuzon secilën dhe të gjitha garancitë e detyrueshme ose të përfshira, garancitë e tregëtimit dhe përshtatjes për një qëllim specifik dhe garancive kundrejt defekteve të fshehura ose të mëvonshme. Nëse Apple nuk mund të refuzojë ligjërisht garancitë e detyrueshme dhe të përfshira, atëherë brenda hapësirës së lejuar ligjore, të gjitha këto garanci do të kufizohen në kohë përgjatë kohëzgjatjes së garancisë së shprehur dhe në shërbimin e riparimit ose zëvendësimit nga Apple, ashtu siç mund ta gjykojë të arsyeshme. Disa shtete (krahina apo provinca) nuk lejojnë kufizime lidhur me kohëzgjatjen e një garancie të përfshirë ose kushti, kështu që kufizimet e mësipërme mund të mos zbatohen në rastin tuaj. Asnjë shitës, agjent ose punonjës i kompanisë Apple nuk është i autorizuar të bëjë modifikime, zgjerime apo shtesa në këtë garanci. Nëse ndonjë nga kushtet konsiderohet të jetë i paligjshëm ose i padetyrueshëm, ligjshmëria ose detyrueshmëria e kushteve të tjera nuk do të ndikohet ose pengohet.

² PËRVEÇSE SIÇ SPECIFIKOHET NË KËTË GARANCI DHE DERI NË LIMITIN MAKSIMAL TË LEJUESHËM NGA LIGJI, APPLE NUK ËSHTË PËRGJEGJËS PËR ASNJË DËM TË DREJTPËRDREJTË, TË VEÇANTË, AKSIDENTAL APO JO TË DREJTPËRDREJTË QË REZULTON NGA SHKELJA E GARANCISË APO KUSHTEVE TË SAJ, APO SIÇ MUND TË JETË PARASHIKUAR NË NDONJË TEORI TJETËR LIGJORE, PËRFSHIRË POR PA U KUFIZUAR NË HUMBJEN E PËRDORIMIT, HUMBJEN E TË ARDHURAVE, HUMBJEVE E FITIMEVE REALE APO TË PARASHIKUARA (PËRFSHIRË EDHE HUMBJEN E FITIMEVE KONTRAKTUALE); HUMBJEN E LIKUIDITETIT; HUMBJEN E FITIMEVE TË PRITSHME; HUMBJEN E BIZNESIT; HUMBJEN E MUNDESIË; HUMBJEN E EMRIT TË MIRË; DËMTIM I IMAZHIT; HUMBJE, DËME APO KORRUPTIM I TË DHËNAVE; APO ÇFARËDOLLOJ HUMBJE APO DËMI DIREKT APO INDIRËKT TË SHKAKTUAR NGA, PËRFSHIRË ZËVENDËSIMIN E PAJISJEVE APO OBJEKTIT NË PRONËSI, SHPENZIMET PËR RIKUPERIMIN E TË DHËNAVE, RIPROGRAMIMIN APO RIPRODHIMIN E PROGRAMEVE APO TË DHËNAVE QË GJENDEN APO QË PËRDOREN ME PRODUKTET APPLE, SI EDHE NGA MUNGESA E RUAJTJES SË KONFIDENCIALITETIT TË TË DHËNAVE TË TILLA. KUFIZIMET E LARTPËRMENDURA NUK DO TË JENË TË APLIKUESHME NË RASTIN E PRETENDIMEVE SI SHKAKTAR VDEKJESH APO DËMTIMESH PERSONALE, APO PËR PËRGJEGJËSI LIGJORE PËR NDONJË VEPRIM NEGLIZHENCE APO MOSVEPRIME TË QËLLIMSHME. APPLE NUK GARANTON SE DO TË JETË NË GJENDJE TË RIPAROJË ÇDO PRODUKT TË MBULUAR NGA KJO GARANCI APO TA ZËVENDËSOJË KËTË PRODUKT PA RREZIKUAR HUMBJEN E PROGRAMEVE APO TË DHËNAVE QË GJENDEN NË TË.

DISA SHTETE (KRAHINA DHE PROVINCA) NUK LEJOJNË PËRJASHTIMIN APO KUFIZIMIN E DËMËVE AKSIDENTALE APO SHKAKORE, KËSHTU QË KUFIZIMET APO PËRJASHTIMET E MËSIPËRME MUND TË MOS JENË TË ZBATUESHME NË RASTIN TUAJ.



TELEKOM ALBANIA SH.A.

Adresa: Rr. "Vangjel Noti", Laprakë, Tiranë

Kjo garanci e kufizuar zbatohet vetëm për produktet hardware të prodhuara nga ose për produktet Apple, të cilat mund të identifikohen nga marka tregtare "Apple", emri tregtar, ose logoja e vendosur në të. Kjo Garanci e Kufizuar nuk zbatohet për asnjë produkt hardware ose software që nuk është i kompanisë Apple, edhe është pakëtuar ose shitur me produktet hardware Apple. Prodhues, furnitorë, ose publikues, të tjerë përveç atyre Apple, mund të ofrojnë garancitë e tyre blerësit final, por Apple, brenda hapësirës ligjore, ofron produktet e tyre "ashtu siç janë". Aplikimet software që shpërndahen nga Apple, me ose pa emrin e markës Apple, (duke përfshirë por pa u kufizuar vetëm në to), nuk mbulohen nga kjo Garanci e Kufizuar. Për detajet e të drejtave tuaja lidhur me përdorimin, referohuni marrëveshjes së licencimit që shoqërojnë aplikimin software. Apple nuk garanton që funksionimi i produktit do të jetë i pandërprerë ose pa gabime. Apple nuk mban përgjegjësi për dëmtimet që lindin nga moszbatimi i i udhëzimeve lidhur me përdorimin e produktit.

Kjo garanci nuk zbatohet:

- a) për pjesë të konsumueshme si bateritë, ose veshje mbrojtëse të dizenuara për t'u konsumuar me kalimin e kohës, përveç rasteve të problemeve si pasojë e defekteve në materiale ose në fabrikimin e tyre;
- b) për dëmtime të jashtme (kozmetike), duke përfshirë, por pa u kufizuar në gërvishje, shtypje dhe plastika të thyera në porte;
- c) për dëmtime të shkaktuara nga përdorimi i produkteve të tjera Jo-Apple;
- d) për dëmtime të shkaktuara nga aksidentet, abuzimi, keqpërdorimi, kontakti me lëngje, zjarre, tërmete ose shkaqe të tjera të jashtme;
- e) për dëmtime të shkaktuara nga përdorimi i produktit përtej përdorimit të projektuar ose të lejuar që përshkruhet nga Apple;
- f) për dëmtime të shkaktuara nga shërbimi (duke përfshirë këtu përmirësimet dhe zgjerimet), i kryer nga kushdo që nuk është përfaqësues i Apple ose Ofrues i Autorizuar i Shërbimit Apple ("AASP");
- g) për produktet ose pjesë të tyre që janë modifikuar për të ndryshuar funksionimin ose aftësinë e produktit pa marrë miratimin me shkrim nga Apple;
- h) për defektet e shkaktuara nga përdorimi (konsumimi) i zakonshëm ose thënë ndryshe nga vjetërimi normal i produktit, ose
- i) nëse ndonjë numër serie i produktit Apple është hequr ose fshirë.

Njoftim i Rëndësishëm: Mos hapni produktin hardware. Hapja e produktit hardware mund të shkaktojë dëmtime që nuk mbulohen nga kjo garanci. Vetëm Apple ose Ofruesit e tij të Autorizuar duhet të kryejë shërbime mbi këtë produkt hardware.

MËNYRA E SHFRYTËZIMIT TË SHËRBIMIT TË GARANCISË

Përpara se të kërkoni shërbimin e garancisë, rekomandohet që të shikoni dhe konsultoni udhëzimet e asistencës në internet të përshkruara më poshtë. Në rast se produkti vazhdon që të mos funksionojë siç duhet edhe pasi keni ndjekur udhëzimet online, ju lutem kontaktoni një përfaqësues të Apple, apo nëse është e mundur, një pikë shitje Apple ("Apple Retail") apo një distributor të autorizuar të shërbimeve wireless Apple, duke përdorur informacionin e dhënë më poshtë.

Në rast se kontaktoni me Apple nëpërmjet telefonit, mund t'iu tarifohen kosto të tjera në varësi të vendndodhjes suaj. Gjatë telefonatës, një përfaqësues apo distributor i autorizuar i Apple do të përcaktojë nëse produkti juaj ka nevojë për servis apo jo, dhe nëse po, do t'ju informojë mbi mënyrën se si Apple do ta kryejë atë. Ju duhet të ofroni ndihmën tuaj gjatë diagnostikimit të produktit dhe të zbatoni procesin e garancisë së Apple.



TELEKOM ALBANIA SH.A.

Adresa: Rr. "Vangjel Noti", Laprakë, Tiranë

Apple mund ta kufizojë ofrimin e servisit vetëm në atë vend ku Apple apo Distributorët e tij të Autorizuar e kanë shitur këtë produkt dhe ta ofrojnë shërbimin e garancisë në një dyqan Apple të shitjes me pakicë apo në pikën e shitjes së distributorëve të autorizuar Apple, të cilët mund ta ofrojnë direkt shërbimin e garancisë apo mund ta dërgojnë këtë produkt në një pikë servisi Apple:

- (a) duke i dërguar klientit fletën e dorëzimit të mallit për transportin e parapaguar (dhe, në rast se klienti nuk ka paketimin origjinal, Apple mund të ofrojë edhe material për paketim) për të mundësuar transportimin e produktit në pikat e servisit Apple, apo
- (b) duke ju dërguar një produkt apo pjesë këmbimi të re apo të rinovuar që mund të instalohet direkt nga klienti për të riparuar apo zëvendësuar produktin me defekt ("Shërbimi DIY").

Sapo klienti merr në dorë produktin apo pjesën zëvendësuese, produkti apo pjesa origjinale kalon në pronësi të Apple, dhe ju bini dakord që të ndiqni udhëzimet, madje nëse është e nevojshme, të kujdeseni për kthimin e produktit apo pjesës origjinale tek Apple në kohën e duhur. Nëse ofrimi i shërbimit DIY kërkon kthimin mbrapsht të produktit apo pjesës origjinale, Apple mund të kërkojë një autorizim për të debituar nga karta juaj e kreditit si garanci një shumë të barazvlefshme me çmimin e shitjes me pakicë të produktit apo pjesës zëvendësuese dhe për shpenzimet e transportit. Nëse ndiqni udhëzimet, Apple do të anulojë debitimin nga karta juaj e kreditit të çmimit të produktit dhe shpenzimet përkatëse administrative. Në rast se ju nuk ktheni produktin apo pjesën e zëvendësuar në përputhje me udhëzimet, Apple do të debitojë nga karta juaj e kreditit shumën e autorizuar.

Tipi i shërbimit, disponueshmëria dhe koha e përgjigjes mund të variojnë në varësi të vendit në të cilin kërkohet shërbimi. Tipi i shërbimit mund të jetë objekt modifikimesh në çdo kohë. Në rast se shërbimi nuk mund të ofrohet në vendin në të cilin është kërkuar, ju mund të jeni përgjegjës për kostot e transportit dhe të trajtimit të mallit. Në rast se shërbimi i garancisë kërkohet në një vend të ndryshëm nga vendi në të cilin produkti është blerë fillimisht, ju duhet të veproni në përputhje me ligjet për importin dhe eksportin dhe do të jeni përgjegjës për të gjitha taksat doganore, TVSH-në dhe taksat apo tatimet që kanë lidhje me to. Në rastin kur shërbimi ndërkombëtar është i disponueshëm, Apple mund të riparojë apo të zëvendësojë produktet dhe pjesët defekte me produkte apo pjesë që përputhen me normat vendase. Në përputhje me legjislacionin në fuqi, Apple mund t'ju kërkojë që të vërtetoni blerjen dhe të kryejë regjistrimin sipas procedurave të kërkuara përpara se të ofrojë shërbimin e garancisë. Informacione të mëtejshme lidhur me marrjen e shërbimit të garancisë, do të mund të gjeni më poshtë.

PRIVATËSIA. Apple do të ruajë dhe do të përdorë informacionet e klientit në përputhje me Politikën e saj të Privatësisë për Klientin, e cila ndodhet e disponueshme në sitin www.apple.com/legal/warranty/privacy.

MBROJTJA E TË DHËNAVE. Në rast se produkti juaj ka mundësi që të ruajë aplikime software, të dhëna dhe informacione të tjera, ju këshillohet që t'i mbronni ato nga ndonjë defekt operacional të mundshëm. Përpara se të dorëzoni produktin për shërbimin e garancisë, është përgjegjësia juaj që të mbani një kopje rezervë të materialeve që dispononi, si dhe të fshini çdo informacion apo të dhëna personale, dhe të çaktivizoni çdo fjalëkalim për sigurinë.

PËRMBAJTJA E PRODUKTIT DO TË FSHIHET, NDËRSA MEMORIA DO TË RIFORMATOHET GJATË SHËRBIMIT TË GARANCISË.



TELEKOM ALBANIA SH.A.

Adresa: Rr. "Vangjel Noti", Laprakë, Tiranë

Produkti juaj apo një produkt zëvendësues do t'ju kthehet i konfiguruar në gjendjen kur është blerë fillimisht, dhe do të jetë objekt i azhornimeve të mundshme. Si pjesë e shërbimit të garancisë, Apple mund të instalojë versione të azhornuara software që e pengojnë produktin të kthehet në një version të mëparshëm të programit të sistemit. Për sa i përket aplikimeve të instaluar në pajisje, ato mund të mos jenë të përshtatshme dhe të mos funksionojnë me hardware-in e pajisjes si rezultat i azhornimit të programit të sistemit. Ju do të jeni përgjegjës për të instaluar sërish të gjitha programet e tjera të software-it, të dhënat dhe fjalëkalimet. Rekuperimi dhe ri-instalimi i programeve të software-it dhe të dhënave të përdoruesit nuk mbulohen nga kjo Garanci e Kufizuar.

Informacion Online: Informacione të mëtejshme lidhur me argumentat e mëposhtme janë të disponueshme online në:

Asistenca Ndërkombëtare
Distributorët e Autorizuar
Ofruesit e Autorizuar të Shërbimit
Apple
Dyqani Apple
Asistencë dhe Servis
Asistencë Falas nga Apple

www.apple.com/support/country
<http://www.apple.com/iphone/countries/>
<http://support.apple.com/kb/HT1937>
<http://www.apple.com/retail/storelist/>
http://www.apple.com/support/contact/phone_contacts.html
<http://www.apple.com/support/country/index.html?dest=complementary>